

VENDIM
Nr. 519, datë 13.6.2013

**PËR KALIMIN NË FOND BANESASH TË ISH-OBJEKTEVE TË DALA NGA
RISTRUKTURIMI I MINISTRISË SË BRENDSHME “ISH-POSTA E POLICISË, LESKOVIK”,
“ISH-DEPO E PIKËS AUTONOME, VLORË”, “STALLË E ISH-EKONOMISË NDIHMËSE,
ORIKUM”, “ISH-REPARTI I OBJEKTEVE, KORÇË” DHE “ISH-LAVANTERI, VAQARR,
TIRANË”, ME QËLLIM PRIVATIZIMIN NË EMËR TË BANORËVE, NGA ENTI KOMBËTAR
I BANESAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, si dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objektet “Ish-posta e policisë, Leskovik”, “Ish-depo e pikës autonome, Vlorë”, “Stallë e ish-ekonomisë ndihmëse, Orikum”, “Reparti i objekteve, Korçë” dhe “Ish-lavanteri, Vaqarr, Tiranë”, të dala të lira nga ristrukturimi i Ministrisë së Brendshme, kalojnë në fond banesash për Entin Kombëtar të Banesave.

2. Pas kalimit të këtyre objekteve në fond banesash dhe regjistrimit të tyre në ZVRPP-të e Vlorës, Korçës dhe Tiranës, Enti Kombëtar i Banesave ngarkohet të lidhë pa kundërshpërblim (vlerën e objektit dhe truallit funksional), kontratat e privatizimit me banorët e pastrehë, të përcaktuar në listën emërore të familjeve, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Shpenzimet operacionale të Entit Kombëtar të Banesave dhe hipotekore të përballohen nga përfituesit.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Vlorë, Korçë, të ndjekin procedurat përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA EMËRORE E ISH-PUNONJËSVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK QË BANOJNË NË
OBJEKTET “ISH-POSTA E POLICISË LESKOVIK”, “ISH-DEPO E PIKËS AUTONOME” VLORË,
“STALLË ISH-EKONOMI NDIHMËSE, ORIKUM” DHE “ISH-REPARTI I OBJEKTEVE KORÇË”**

Objekti “Ish-posta e policisë Leskovik”

1. Mestan Cenolli
2. Roland Malushi
3. Kastriot Nure
4. Thanas Perici

Objekti “Ish-depo e pikës autonome, Vlorë”

1. Bardhosh Nuraj Vlorë

Objekti “Stallë, ish-ekonomi ndihmëse, Orikum”

1. Hektor Shena
2. Dritan Zagani

Objekti “Reparti i objekteve, Korçë”

1. Ilirjan Hamza
2. Orhan Sulollari
3. Sali Bracellari

Objekti “Ish-lavanteri, Vaqarr, Tiranë”

1. Astrit Sinanrrapaj